





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV Dukagjini
Ermal Panduri
Drejtor
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2021/25- Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për
TV Dukagjini (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, përmes të cilit përcaktohet sjellja e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin e VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje e Përgjithshme Nr. 03/L-073, Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
2. Me datë 18 tetor 2019, Komisioni i KPM-së mori Vendim që Pala Përgjegjëse të sanksionohet në shumë prej katër mijë (4,000) euro për shkelje të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073 dhe Rregullores për Komunikimet Komerciale audiovizuale KPM 2017/07.
3. Me datë 26 janar 2021, KPM i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073. Qëllimi i dërgimit të udhëzuesit ka qenë që të licencuarve t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore.
4. KPM, me datën 1 shkurt 2021, elektronikisht i ka njoftuar të gjithë të licencuarit e KPM-së se duke u bazuar në mandatin ligjor është duke i monitoruar mediat për pajtueshmërinë e tyre me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, duke ua rikujtuar se është i ndaluar sponsorizimi dhe vendosja e produkteve në emisionet e lajmeve dhe programet për çështje aktuale me interes për publikun.
5. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë se, Palës Përgjegjëse ka iniciuar monitorim të programit gjatë fushatës zgjedhore nga data 3 deri me 14 shkurt 2021. Bazuar në Raportin e monitorimit ka konstatuar se Pala Përgjegjëse me datë 3 dhe 4 shkurt 2021 ka transmetuar spote politike të subjekteve të ndryshme politike të cilat i ka identifikuar si spote me pagesë dhe hapësirë e sponsorizuar, por nuk ka identifikuar qartë se nga kush janë të paguara apo të sponsorizuara, duke vepruar kështu në kundërshtim me neni 49, paragrafi

6, të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073. Po ashtu në emisionin "Debat Plus" ka pasur reklamim me ekran të ndarë, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 1, të Rregullores për Komunikimet Komerciale Audiovizuale 2017/07. Gjithashtu, është gjetur se emisioni "Debat Plus" ka qenë i sponsorizuar, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 31, paragrafi 4, të Ligjit të KPM-së 04/L-44.

6. KPM, pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 5 shkurt 2021, i ka dërguar Palës Përgjegjëse elektronikisht Njoftim për shkelje, përmes të cilit e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe e ka udhëzuar që menjëherë të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së gjatë procesit të fushatës zgjedhore në Republikën e Kosovës.
7. Edhe përkundër Njoftim për shkelje, KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 shkurt 2021, ka konstatuar se Pala Përgjegjëse ka vazhduar të ketë reklamim me ekran të ndarë në emisionin për çështjet aktuale "Debat Plus". Po ashtu, është gjetur se ka transmetuar spote politike të subjektit politik Nisma Social Demokrate (Nisma) Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), si dhe një intervistë me përfaqësuesen e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), të cilat identifikohen se janë hapësira të sponsorizuara, mirëpo nuk është e qartë organizata apo individi përgjegjës për to, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073. Gjithashtu, KPM ka konstatuar se emisioni "Debat Plus" vazhdon të jetë i sponsorizuar, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 31, paragrafi 4, të Ligjit të KPM-së 04/L-44.

Analiza tregëtare

8. Komisioni i Pavarur i Mediave, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, nenin 31, paragrafi 4 të Ligjit të KPM-së dhe nenin 12, paragrafi 1 të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikime Komerciale.
9. KPM konstaton se edhe pse Pala përgjegjëse është njoftuar me kohë për respektim të Ligjit Nr. 03/L-073 për zgjedhje, Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, i është dërguar Udhëzuesi me qëllim që t'ju ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore, sërish është gjetur në shkelje. Bazuar në Raport të monitorimit KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka transmetuar spote politike të subjekteve të ndryshme politike të cilat i ka identifikuar si spote me pagesë dhe hapësirë e sponsorizuar, por nuk ka identifikuar qartë organizatën apo individin përgjegjës për to, duke vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhje Nr. 03/L-073 i cili përcakton se:

"Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin "përgjegjës për të."

10. Bazuar në Raport të monitorimit KPM ka konstatuar se emisioni "Debat Plus" vazhdon të jetë i sponsorizuar, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 31, paragrafi 4, të Ligjit të KPM-së 04/L-44, i cili përcakton se:

“Programet e lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale nuk do të sponsorizohen.”

11. KPM, bazuar në Raportet e monitorimit, ka konstatuar se emisioni për çështjet aktuale “Debat Plus” vazhdon të ketë reklamim me ekran të ndarë, duke vepruar në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, i cili përcakton se:

“Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t’ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë.”


12. Komisioni si rrethanë rënduese për Palën Përgjegjëse e konsideron edhe dështimin e këtij subjekti për të vepruar në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073 dhe Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07, konkretisht në zgjedhjet e vitit 2019.
13. Prandaj, KPM, duke u bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 49, paragrafi 6 të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, nenit 31, paragrafi 4 të Ligjit të KPM-së dhe nenit 12, paragrafi 1 të Rregullores për Komunikime Komerciale KPM2017/07.

Vendim

14. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumë prej shtatë mijë e pesëqind (7.500) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 31, paragrafi 4, të Ligjit të KPM-së, nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për Komunikime Komerciale KPM2017/07 dhe nenit 49, paragrafi 6, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.

E drejta për ankesë

15. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t’i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërishit relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar



11.02.2021
Datë